

Data 12/03/2026

PROCESVERBAL - TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “PRIME SIGURIMI AUTOMJETE” .

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **SHËRBIME
SIGURIMI 98341140-8.**

VLERA E FONDIT LIMIT: **3,100,000 (Tre milion e njëqindmijë) Lek.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor KESH sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë: Sa më sipër.

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Kjo kërkesë përmbushet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.10.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e fondit të përlogaritur të kontratës.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në llojin e procedurës së prokurimit e cila është: “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, argumentohet si më poshtë:

- Përcaktimi i vlerës së kërkuar është një kërkesë e mbështetur në pikën 4 të nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Për Autoritetin Kontraktor KESH sh.a, plotësimi i këtij kriteri është i rëndësishëm pasi shërbimet e mëparshme të ngjashme të realizuara në sektorin publik apo sektorin privat janë kushte të nevojshme që garantojnë se Operatorët Ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të mëparshme të ngjashme vërtetojnë se zotërojnë kapacitete për të zbatuar me sukses këtë procedure prokurimi.

2.3.2 Në zbatim të Ligjit Nr.52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të ri sigurimit”, Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin Licencën Profesionale për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit në klasat 3, 10, 12 të lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe të Ligjit Nr.52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të ri sigurimit”.

Me anë të këtij kriteri, dëshmohet se operatorët ekonomikë janë të pajisur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me licencat profesionale të cilët ushtrojnë veprimtari në klasat e sigurimit përkatës, sipas legjislacionit në fuqi.

Klasat e sigurimit janë vendosur në përputhje me llojet e mjeteve të Autoritetit Kontraktor KESH sh.a, si dhe klasat e sigurimit të kërkuara.

Në Aneksin 1, “Klasat e Sigurimit”, të Ligjit Nr.52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të ri sigurimit”, ndër të tjera citohet :

A. Veprimtaria e sigurimit të jo jetës përfshinë klasat e mëposhtme:

Klasa 3 - Sigurimi i mjeteve tokësore (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina) mbulon dëmtimet ose humbjet nga: 3.1 mjetet tokësore motorike, 3.2 mjetet tokësore jo motorike.

Klasa 10 - Sigurimi i përgjegjësive nga përdorimi i automjeteve mbulon të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i automjeteve mbi tokë (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit dhe mbulimin e përgjegjësive të detyrueshme).

Klasa 12 - Sigurimi i përgjegjësive për anijet (detare, të liqeneve dhe të lumenjve, si dhe ato të kanaleve) mbulon të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i anijeve ose barkave (anije të vogla), që lundrojnë në det, liqene, lumenj dhe kanale lundrimi (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës për përgatitjen e specifikimeve teknike, referuar nevojës për sigurim të detyrueshëm për automjetet në pronësi të Korporatës Elektroenergjitike Sh.a si dhe në zbatim të Ligjit nr. 32/2021, datë 16.03.2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”,

Sigurimi i automjeteve është një domosdoshmëri funksionale dhe një masë përgjegjësie institucionale për mbrojtjen e interesit publik dhe të pasurisë së institucionit. Sigurimi i detyrueshëm i mjeteve motorike është i parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Mbikëqyrja dhe rregullimi i tregut të sigurimeve realizohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Çdo mjet që qarkullon në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të jetë i pajisur me policë sigurimi të vlefshme. Mosrespektimi i këtij detyrimi sjell masa administrative, gjoba dhe pezullim të qarkullimit të mjetit.

Aktualisht, Institucioni disponon automjete të cilat përdoren për: *Kryerjen e detyrave funksionale dhe administrative, lëvizje zyrtare të stafit, transport materialesh dhe dokumentacioni, përfaqësim institucional, etj.*

Duke qenë se këto mjete qarkullojnë rregullisht, ekziston rreziku i përfshirjes në aksidente rrugore apo dëmtime të tjera të paparashikuara ku mungesa e siguracioneve përkatëse do të sillte pasoja të mundëshme si: Institucioni do të përballej me kosto të konsiderueshme financiare për dëmet ndaj palëve të treta, mund të lindin përgjegjësi ligjore dhe administrative, do të cenohej imazhi dhe funksionimi normal i institucionit etj.

Njësia e Prokurimit